



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Në këtë raportim të parë, dëshiroj të shpreh fillimisht falenderime për votëbesimin tuaj ndaj kandidaturës sime në drejtim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Ky votëbesim është edhe më domethënës në situatën aktuale, duke pasur parasysh se roli i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare theksohet edhe më tepër në raste krizash financiare apo ekonomike.

Goditjet me të cilat u përball vendi, situata e pandemisë dhe më herët tërmetet e fundvitit 2019, kanë pasur një ndikim domethënës në ekonominë e vendit dhe sigurisht kanë qenë të ndjeshme edhe për veprimtarinë e sektorit financiar.

Sidoqoftë, në terma të përgjithshëm ne vlerësojmë se sektori financiar në vend ka qenë rezistent ndaj këtyre goditjeve dhe deri në këtë moment vazhdon të mbetet i qëndrueshëm.

Megjithatë, ndikimi i pandemisë është ende i ndjeshëm dhe rreziqet që vijnë prej saj, pasur parasysh efektet e pandemisë jo vetëm në ekonominë tonë, por edhe në ekonominë dhe tregjet rajonale e globale, mbeten prezente.

Në këtë pikë, është e rëndësishme për Autoritetin, dhe patjetër për operatorët e sektorit, marrja e masave për një përballim sa më të kujdesshëm të efekteve vazhduese të kësaj situatë.

Autoriteti u ka kërkuar të gjithë operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale plane të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave, ku të detajohen të gjithë elementët teknikë, logjistikë, njerëzorë dhe financiarë për përballimin e efekteve të mundshme.

Gjithashtu, në linjë me rekomandimet e autoriteteve rregullatore evropiane, ju është kërkuar operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje të vlerësojnë efektet e pandemisë për konsumatorët, por edhe për vetë shoqëritë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka marrë vendim që deri në fund të vitit të mos ketë asnjë shpërndarje fitimi nga subjektet nën mbikëqyrje, në mënyrë që kapitalet të mbahen në sistem, duke vlerësuar këtë si një nga mënyrat më efektive për të rikuperuar luhatje të mundshme të treguesve.

Është duke u monitoruar në vazhdimësi likuiditeti në tregun e sigurimeve si dhe po monitorohen tërheqjet nga fondet e investimeve dhe pensioneve private vullnetare.

Tregu i sigurimeve ishte tregu më i ndikuar nga pandemia. Në periudhën e karantinës, ky treg pati rënie të të ardhurave deri në 50% krahasuar me një vit më parë, por, me lehtësimin e masave, goditja është zbutur ndjeshëm dhe për 6-mujorin e parë të vitit, primet e shkruara bruto janë në vetëm minus 6.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pati gjithashtu tërheqje nga fondet e investimeve, të cilat mund të konsiderohen të ndjeshme për harkun kohor në të cilin ndodhën, por këto tërheqje nuk e cënuan shëndetshmërinë e tregut.

Autoriteti po monitoron nga afër zhvillimet dhe është në kontakt të ngushtë me homologët evropianë dhe organizatat ndërkombëtare të mbikëqyrësve për të vlerësuar dhe zbatuar praktikat më të mira në përballimin e situatës.

Gjatë kësaj jave u zhvillua mbledhja e rradhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, ku Autoriteti së bashku me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave ndanë qëndrimet mbi ndikimin e situatës pandemike dhe masat për të zbutur rreziqet dhe forcuar rezistencën e sistemit financiar. Në veçanti, u ra dakord që industria financiare dhe autoritetet përkatëse rregullatore të harmonizojnë veprimet me qëllim që:

- (a) Informacioni dhe analizat për veprimtarinë e sistemit financiar, dhe veçanërisht për drejtimet që ndikohen nga pandemia, të jetë sa më i plotë, frekuent dhe në kohën e duhur, me qëllim që t'i shërbejë në mënyrë efektive vendimmarrjes;
- (b) Institucionet financiare të fuqizojnë kapacitetet analitike si instrument i domosdoshëm për të vlerësuar rezistencën e tyre ndaj zhvillimeve ekonomike të pafavorshme, duke përfshirë skenarë specifikë dhe të shtrirë në kohë.
- (c) Të vijojë monitorimi i zhvillimeve, duke ju kërkuar aktorëve financiarë ruajtjen e standardeve më të larta të transparencës dhe të treguesve prudencialë.

Sa i përket veprimtarisë së Autoritetit dhe ecurisë së tregjeve për vitin 2019, që është edhe raporti që është sot në shqyrtim:

Në përgjithësi, tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, tregu i sigurimeve, tregu i kapitaleve dhe i fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare patën ecuri pozitive. Në fund të vitit 2019, totali i aktiveve në këto tregje u rrit me 6.7%, duke arritur në 108.8 miliardë lekë, ose 6.5% e PBB-së.

Në tërësi, **tregu i sigurimeve** gjatë vitit 2019 u rrit me 4.1%, duke arritur në 17.6 miliardë lekë prime të shkruara bruto. Sigurimi i Jo-Jetës zë rreth 93% të totalit të primeve, ndërsa sigurimi i detyrueshëm zë 63.7% të totalit të tregut. Kjo bën të domosdoshme diversifikimin e produkteve të sigurimeve vullnetare, që do të ulnin varësinë e tregut ndaj sigurimit të detyrueshëm motorik.

Ngjarjet e tërmeteve të fundvitit 2019 vunë në provë tregun e sigurimeve. Totali i kërkesave për dëmshpërblim për të dy tërmetet arriti në 4.12 miliardë lekë, për një total prej 6,249 kërkesash, nga të cilat deri më sot 5,154 kërkesa për dëmshpërblime janë paguar.

Pas ngjarjeve të tërmetit, Autoriteti vendosi rritjen me 34.4% të provigjoneve teknike në nivel tregu për kompanitë e sigurimit, çka e bën tregun e sigurimeve të mirëprovigjonuar dhe jep mundësi për të përballuar shlyerjen totale të dëmeve.

Është për t'u theksuar se ngjarjet e tërmetit kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e zgjerimit të mbulimit të sigurimit të pronës, duke qenë se vetëm 2.5% e banesave në vend kanë një mbulim të tillë dhe pjesa më e madhe e tyre, e kanë këtë mbulim për efekt kredie.

Tregu i fondeve të investimeve ka vijuar rritjen, si në strukturë, edhe në shifra. Vlera neto e aktiveve të fondeve të investimit në fund të vitit 2019 arriti në rreth 66.8 miliardë lekë.

Edhe **tregu i fondeve të pensioneve private vullnetare**, u rrit me rreth 27% krahasuar me vitin 2018 në vlerë aktivesh, edhe pse ky i fundit mbetet një treg modest me mundësi për t'u zhvilluar më tej.

Tregu i kapitaleve, edhe gjatë vitit 2019, përbëhej nga tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i Obligacioneve të Emetuara me Ofertë Private.

Vlera totale e tregtimit në Bursën Shqiptare për vitin 2019 arriti në 1.47 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet e kryera midis bankave. Gjatë vitit 2019 u kompletua infrastruktura e nevojshme për klerimin dhe shlyerjen e titujve korporativë në Bursë, nëpërmjet licencimit të “Regjistrimit Shqiptar të Titujve”.

Me synim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitaleve, Autoriteti ka ndërmarrë së fundmi iniciativën e hartimit të një Dokumenti Strategjik dhe një plani konkret veprimi së bashku me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë.

Autoriteti është angazhuar për të realizuar të gjitha kërkesat e vendosura nga rezoluta e Kuvendit. Autoriteti ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, si dhe realizimin e objektivave që lidhen me procesin e integritetit, sidomos në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor dhe përshtatjes me Direktivat e BE-së.

Dy ligjet e miratuara së fundmi “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe “Për Tregjet e Kapitalit”, përafrojnë në një masë të gjerë legjislacionin tonë me atë të BE-së dhe modernizojnë kuadrin rregullator ekzistues.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka adresuar rekomandimet e lëna nga Komiteti MONEYVAL, në funksion të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë një sërë masash si në aspektin rregullator, ashtu edhe në kuadrin mbikëqyrës.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Gjatë vitit 2020, drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohen në:

- Menaxhimin e situatës dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së tregjeve të mbikëqyrura;
- Plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator, veçanërisht në hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve përkatëse për ligjet e miratuara, me qëllim implementimin e plotë të tyre;
- Arritjen e standardeve të larta të mbikëqyrjes, duke avancuar drejt një mbikëqyrjeje të plotë me bazë rreziku, në linjë me standardet e Solvency II;
- Digjitalizimin dhe modernizimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, nëpërmjet zgjerimit të përdorimit të teknologjisë së informacionit në funksion të raportimit, inspektimit, si edhe krijimit të e-shërbimeve.
- Në funksion të mbrojtjes së personave të siguarar dhe investitorëve, me synim nxitjen e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje, Autoriteti do të angazhohet në hartimin e strategjisë së re “Për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, për të zëvendësuar strategjinë që përfundon në vitin 2020.

Së fundmi, dëshiroj të theksoj se Autoriteti mbetet plotësisht i angazhuar për të ndjekur dhe zbatuar të gjitha rekomandimet e Kuvendit, që do të marrin miratimin tuaj në këtë seancë plenare.

Falënderit!